



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar mbi “Auditimin e kontrolleve bazë të Teknologjisë së Informacionit”
në Zyrën Rajonale Statistike Fier**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

**MBI AUDITIMIN E “KONTROLLEVE BAZË TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT”**

NË

“ZYRËN RAJONALE STATISTIKORE FIER”



Tiranë, korrik 2025

PËRMBAJTJA

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4
	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	4
II	HYRJA	5
	1. Objektivat dhe qëllimi	6
	2. Identifikimi i çështjeve	6
	3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar	6
	4. Përgjegjësitë e audituesve	6
	5. Kriteret e vlerësimit	7
	6. Standardet e auditimit	7
	7. Metodatat e auditimit	8
	8. Dokumentimi i auditimit	8
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	8
	1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	8
	2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	9
	2.1. Auditimi mbi Kontrollat bazë të Teknologjisë së Informacionit	9-11
	2.2. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave Statistikore	11
IV.	REKOMANDIME	11

1.PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) mbështetur në nenet 3 dhe 14 të ligjit 154 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, datë 27.11.2014, zhvilloi një auditim të Teknologjisë së Informacionit Zyrën Rajonale Statistikore Fier nga data 25.03.2025 deri më datë 28.04.2025.

Grupi i auditimit mblodhi informacione, zhvilloi pyetësorë e intervista për caktimin e zonave me risk të lartë dhe mbështetur në to hartoi matricat e auditimit.

Kërkesat për informacion për fushat përkatëse u hartuan në përputhje me manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Projekti i auditimit, për auditimin e Sistemeve të Teknologjisë së Informacionit, në Zyrën Rajonale Statistikore Fier është pjesë e Planit Vjetor 2025 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. INSTAT ka mision të prodhojë statistika cilësore, asnjëse, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Zyra Rajonale Statistikore (ZRS) Fier merr nga Sektori i Koordinimit të Mbledhjes së të Dhënave, INSTAT qendër “Kalendarin e vrojttimeve” në të cilin janë të përcaktuara (miratuara) të gjitha anketat e planifikuara që do të kryhen brenda vitit kalendarik si dhe planifikimi mbi numrin dhe llojin e njësive statistikore që do të vrojtohen, metodën e mbledhjes së të dhënave në terren, numrin e anketuesve të planifikuar si dhe planifikimin për datat e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes së të dhënave në çdo vrojtim.

Auditimi i kontrolleve bazë të Teknologjisë së Informacionit është i rëndësishëm për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit përcaktohet si mundësia e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me termat e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Sistemet e informacionit janë bashkime komplekse të teknologjisë, proceseve dhe njerëzve që funksionojnë së bashku për të rregulluar përpunimin, ruajtjen, dhe transferimin e informacionit për të mbështetur misionin e institucionit dhe funksionet e tij. Përzgjedhja e këtij subjekti është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit, ku KLSH ka vlerësuar si të rëndësishëm auditimin e kontrolleve bazë të teknologjisë së Informacionit të Zyrës Rajonale Statistikore (ZRS) Fier, për të garantuar disponibilitet dhe integritet të të dhënave. Mbështetur në punën në terren, evidencat e marra kanë qenë të mjaftueshme dhe të besueshme për punën audituese. Pas marrjes së ambienteve të përshtatshme, grupi auditues filloi fazën e studimit paraprak, ku u dërgua pyetësori i hartuar nga grupi i auditimit, bazuar në Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i auditimit është miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit me nr.273/1 me datë 25.03.2025.

I.2. Paraqitja e gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

Nga shqyrtimi i evidencave rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet mangësi në drejtimin e Teknologjisë së Informacionit. Grupi i auditimit ka konstatuar 6 gjetje dhe ka dhënë 6 rekomandime.

Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejttimeve më poshtë:

- Në strukturën organizative të Zyrës Rajonale Statistikore Fier konstatohet se, nuk ka specialist që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit, për të garantuar sigurinë e informacionit referuar standardit ISO/IEC 27001 dhe praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare.

Mungesa e këtij specialisti nuk adreson në kohë problemet teknike, si dhe nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme politikat dhe masat e sigurisë kibernetike të teknologjisë së informacionit.

- Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit i aksesojnë kompjuterët si administrator lokal, pra me të drejta të plota për të kryer lirshëm veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme *software* pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm, sikurse përcaktohet në Standardin Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

- Zyra Rajonale Statistikore Fier ka përgjegjësi vetëm për mbledhjen e të dhënave në terren, por nuk janë përdorues të sistemeve qendrore të INSTAT për plotësimin e të dhënave statistikore. Komunikimi për të dhënat e nevojshme që kërkohen nga INSTAT, realizohet nëpërmjet rrugëve alternative që janë posta elektronike ose shërbimi postar, në kundërshtim me Ligjin Nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare, neni 12.

Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

- Zyra Rajonale Statistikore Fier të kërkojë nga Instituti i Statistikave (INSTAT), asistencë dhe konsulencë për të adresuar rreziqet dhe masat që duhet të marrë për rritjen e sigurisë kibernetike të teknologjisë së informacionit.

- Zyra Rajonale Statistikore Fier të marrë masa për kufizimin e të drejtave të përdoruesve, duke hequr aksesin e panevojshëm si administrator lokal si dhe duke implementuar parimin e privilegjit minimal.

- Zyra Rajonale Statistikore Fier në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), të hartojë dhe të miratojë rregullat bazë udhëzues për menaxhimin e teknologjisë së informacionit për nivelin lokal.

1.3 Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit:

Mbështetur në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, përkatësisht ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310, si dhe në nenet 3 dhe 14 të Ligjit nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, auditimi evidentoi mungesë të praktikave të standardizuara për menaxhimin e infrastrukturës së TI dhe sigurisë së informacionit. Mungesa e qendërimit në menaxhimin e infrastrukturës TI, përdorimi i llogarive me privilegje të plota dhe mungesa e udhëzimeve të qarta operacionale, ekspozojnë Zyrën Statistikore Fier ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit. Zyra Rajonale Statistikore Fier nuk është përdorues i sistemeve qendrore statistikore, çfarë krijon mundësi për gabime njerëzore në të dhënat statistikore që komunikohen në rrugë alternative.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Programit të Auditimit 273/1 Prot, datë 25.03.2025, të miratuar nga Kryetari i KLSH, me afat auditimi 25.03.2025 deri në 28.04.2025, në Zyrën Rajonale Statistikore Fier, (më poshtë ZRS Fier), ku periudha e audituar është 01.01.2023 deri në 31.12.2024, u krye auditimi me objekt “*Auditimi i Kontrolleve Bazë të Teknologjisë së Informacionit*”, nga audituesit:

1. R.A, përgjegjës grupi
2. M.P, anëtare

II.1. Objektivat dhe qëllimi auditimit

Objekti i auditimit është vlerësimi i përdorimit dhe menaxhimit të burimeve të teknologjisë së informacionit nga Zyra Rajonale e Statistikave Fier, me fokus tek ekzistenca dhe efektiviteti i kontrolleve kryesore për mbrojtjen e të dhënave. Auditimi ka pasur për qëllim të përcaktojë

nëse praktikat e ndjekura janë në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të INSTAT dhe standardet e sigurisë së informacionit, si dhe nëse sigurohet kofidencialiteti, integriteti dhe disponueshmëria e informacionit. Qëllimi i auditimit të kryer në Zyrën Rajonale të Statistikave Fier është të ofrojë një vlerësim të pavarur mbi gjendjen aktuale të kontrolleve të teknologjisë së informacionit, në raport me menaxhimin, sigurinë, mirëmbajtjen dhe përdorimin e infrastrukturës ekzistuese. Auditimi synon të identifikojë dobësitë dhe proceset teknologjike, të vlerësojë rreziqet e mundshme. Për realizimin e këtij qëllimi, janë mbledhur dhe analizuar të dhëna, dokumente, në përputhje me Manualin e Auditimit të Teknologjisë së Informacionit dhe në bazë të standardeve ndërkombëtare ISSAI 100, ISSAI 5300 dhe ISSAI 5310.

II.2 Identifikimi i çështjeve:

Drejtimit e këtij auditimi janë bazuar në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit të protokolluar me nr.273/1 Prot, datë 25.03.2025:

1. Auditimi mbi Kontrollin bazë të Teknologjisë së Informacionit;
2. Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave Statistike.

II.3 Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar

Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika cilësore, asnjënjë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit e transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpiqet t'u përgjigjet kërkesave gjithnjë e në rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor relativ, të sigurt dhe të krahasueshëm. Me dëshirën për të nxitur përdorimin gjithnjë e më shumë të statistikave zyrtare në zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit si dhe identifikimin në vazhdimësi të nevojave të përdoruesve, INSTAT përdor të gjitha mjetet tradicionale dhe moderne që ka në dispozicion për shpërndarjen e informacionit statistikor. INSTAT punon në vazhdimësi në drejtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave zyrtare, duke respektuar parimet e cilësisë statistikore të parashikuara në ligjin shqiptar të statistikave, dhe standardet e Kombeve të Bashkuara. Instituti i Statistikave është person juridik i pavarur në varësi të Kuvendit të Shqipërisë i cili siguron që statistikave janë zhvilluar, prodhuar dhe shpërndarë sipas Programit të Statistikave Zyrtare si dhe jep ndihmën profesionale për interpretimin e drejtë të tyre. INSTAT e ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për statistikave zyrtare”, aktet ligjore e nënligjore në zbatim të tij, si dhe është institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare dhe koordinimin e Sistemit Kombëtar Statistikor. INSTAT përgjigjet për ruajtjen e të dhënave kofidenciale të mbledhura nga njësitë statistikore.

II.4 Përgjegjësitë e audituesve

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Zyrën Rajonale Statistike Fier, mbi periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2023 deri në 31.12.2024, duke i kushtuar vëmendje çështjeve që lidhen me zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë si dhe standardeve ndërkombëtare të teknologjisë dhe auditimit TIK.

Nga grupi i auditimit, me përgjegjësi të plotë, janë analizuar të gjitha çështjet që përmban Programi i Auditimit nr. 273/1 Prot, datë 25.03.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH. Në realizimin e këtij Projekt Auditimi, grupi i auditimit është mbështetur në bazën ligjore mbi të cilën funksionon KLSH, standardet e auditimit, legjisllacionin e fushës në të cilën operon Zyra Rajonale Statistike Fier. Gjithashtu, gjatë veprimtarisë audituese, është siguruar një evidencë e përshtatshme, e mjaftueshme dhe e besueshme auditimi, në të cilën jemi mbështetur në dhënien e konkluzioneve dhe rekomandimeve. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me

kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij.

II.5 Kriteret e vlerësimit

Kriteret e vlerësimit janë bazuar në ligjet, rregulloret në fuqi, standardet ndërkombëtare COBIT dhe ISSAI 5300 për auditimin e Teknologjisë së Informacionit si dhe Manualin e Teknologjisë së Informacionit. Opinioni i auditimit mbështetet në praktikën më të mira, Standardet Kombëtare dhe Ndërkombëtare të Auditimit. Në këtë projekt raport krahas gjetjeve që janë konstatuar, grupi i auditimit ka rekomanduar disa masa organizative, për përmirësimin e situatës.

Aktet ligjore dhe rregullative mbi të cilat është mbështetur vlerësimi janë si më poshtë:

- Standarde Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t;
- Udhëzues dhe Manuale të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit si: ISSAI 5300, Manuali Aktiv i Auditimit IT si dhe Standardet e COBIT, ISO/IEC 27001 Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit;
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (nenet 162-165);
- Ligji nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 17/2018 për Statistikat Zyrtare;
- Ligj nr. 30/2022 “Për miratimin e programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026”;
- Ligji Nr. 43/2023 "Për Qeverisjen Elektronike";
- Ligji Nr. 25/2024, “Për Sigurinë Kibernetike”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe aktet ligjore në zbatim të tij;
- Vendim i Kuvendit nr. 3/2023 për miratimin e Planit Vjetor 2023 për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026;
- Rregullore e Brendshme - Zyrrat Rajonale Statistikore;
- Akte të tjera ligjore apo nënligjore që do të jenë të nevojshme gjatë auditimit.

II.6 Standardet e auditimit

Auditimi është kryer, në përputhje me Kodin Etik, Standardet, dhe teknikat e auditimit të teknologjisë së informacionit, duke përfshirë pyetësorë, intervista, testim dhe procedura, të cilat u gjykuan se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësim sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë, duke u fokusuar veçanërisht në standardet e fushës së auditimit të TIK, si: COBIT 4.1, Manuali i Auditimit IT, ISSAI 5310, etj.

II.7 Metodatat e auditimit

Metodat mbi auditimin e sistemeve të Teknologjisë së Informacionit që grupi i auditimit ka ndjekur në Zyrrën Rajonale Statistikore Fier, janë si më poshtë:

- Intervista zhvilluar në subjekt me personat përgjegjës;
- Verifikime të sistemit si auditues;
- Shqyrtimi i dokumentacionit rregullativ të institucionit;
- Analizimi i të dhënave të eksportuara nga sistemi.

II.8 Dokumentimi i auditimit

Dokumentimi i auditimit është bazuar në rregulloren e brendshme të KLSH si dhe në manualin aktiv të auditimit të Teknologjisë së Informacionit në të cilin janë përfshirë:

- Planifikimi, qëllimi dhe objektivat e auditimit;
- Programi i auditimit;
- Evidencat e grumbulluara në lidhje me të dhënat e sistemit, raporte të ndryshme me të dhëna nxjerrë nga sistemi;
- Letrat e punës mbajtur nga audituesit sipas detyrave të përcaktuara gjatë fazës së auditimit në terren.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Sistemi statistikor në shtetin shqiptar është themeluar me Vendimin nr. 35, datë 13.01.1945 me krijimin e Drejtorisë së Statistikës të atashuar pranë Këshillit të Ministrave. Më vonë kjo drejtori kaloi nën varësinë e Komisionit të Planit të Shtetit.

Në zbatim të ligjit nr. 17, datë 05.04.2018 “Për statistikatat zyrtare”, ky sistem përbëhet nga një numër institucionesh të ngarkuar për prodhimin e statistikave zyrtare dhe institucione të tjera, publike ose jo, të cilët nxjerrin statistika të fushave të ndryshme për monitorimin apo zbatimin e politikave të veta zhvilluese. Sistemi Kombëtar Statistikor e ushtron aktivitetin në përputhje me ligjin e lartpërmendur dhe Programin shumëvjeçar të Statistikave i cili miratohet me vendim të veçantë të Kuvendit të Shqipërisë. Përgjegjës për zbatimin e Programit dhe monitorimin e Sistemit Statistikor është Instituti i Statistikave si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare. Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika cilësore, asnjënjë, transparente dhe të përditësuara, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve mbi proceset e zhvillimit dhe transformimit në fushat ekonomiko-sociale brenda vendit. Si institucioni që disponon burimin më të madh të informacionit statistikor në Shqipëri, INSTAT përpunon t’u përgjigjet kërkesave gjithnjë e më rritje të përdoruesve për vendimmarrje, kërkime dhe arsimim në Shqipëri. INSTAT ndihmon komunitetin e interesuar ndërkombëtar nëpërmjet sigurimit të informacionit statistikor sipas standardeve të kërkuara, të besueshëm, të sigurt dhe të krahasueshëm. Me dëshirën për të nxitur përdorimin gjithnjë e më shumë të statistikave zyrtare në zhvillimet ekonomike dhe sociale të vendit si dhe identifikimin në vazhdimësi të nevojave të përdoruesve, INSTAT përdor të gjitha mjetet tradicionale dhe moderne që ka në dispozicion për shpërndarjen e informacionit statistikor. INSTAT punon në vazhdimësi në drejtim të përmirësimit të cilësisë së statistikave zyrtare, duke respektuar parimet e cilësisë statistikore të parashikuara në ligjin shqiptar të statistikave, *acquis communautaire* dhe standardet e Kombeve të Bashkuara.

2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Auditimi mbi Kontrollat bazë të Teknologjisë së Informacionit

Në zbatim të pikës 1 “*Auditimi mbi Kontrollat bazë të Teknologjisë së Informacionit*”, të Programit të Auditimit nr. 273/1, datë 25.03.2025, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Akte ligjore / nënligjore, rregullore mbi të cilat institucioni kryen aktivitetin e tij;
- Intervista me punonjësit;
- Pyetësorë drejtuar Zyrës Rajonale Statistimore Fier;

Qëllimi i auditimit është të vlerësojmë nëse praktikatat dhe kontrollat aktuale të TI-së janë të mjaftueshme për të siguruar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave të sistemeve të informacionit.

Burimet njerëzore

Zyra Rajonale Statistimore Fier është krijuar me VKM nr. 97, datë 15.3.1994 “*Për krijimin e Drejtorive të Statistikës në rrethe, të Drejtorive ose Sektorëve të Statistikës në Ministri e institucione të tjera qendrore, si dhe për numrin e punonjësve të tyre*”. Struktura e degës është e përcaktuar me Vendimin e Kuvendit nr. 16/2024 “*Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimin e pozicioneve të punës të Institutit të Statistikave*”.

Nga auditimi u konstatua se në strukturën e miratuar Zyra Rajonale Statistimore Fier ka një numër total prej 6 punonjësish, përkatësisht 1 përgjegjës dhe 5 specialistë nga të cilët 2 në Fier, 1 në Lushnje dhe 1 në Mallakastër. Që nga krijimi i institucionit e deri më tani, Zyra Rajonale Statistimore Fier nuk ka pasur një punonjës të teknologjisë së informacionit.

Zyra Rajonale Statistimore Fier është struktura përgjegjëse për zhvillimin e procesit të mbledhjes së të dhënave brenda rajonit statistikor në të cilin ajo vepron në kuadër të plotësisht të Programit

të Statistikave Zyrtare, Planit Vjetor të aktiviteteve statistikore të INSTAT apo angazhimeve të tjera të marra nga organet Drejtuese për prodhimin e statistikave.

Verifikim i politikave dhe procedurave në TIK

Grupi i auditimit, me qëllim auditimin e nivelit të dokumentimit të politikave dhe procedurave në lidhje me teknologjinë e informacionit, verifikoi rregulloret e institucionit, si dhe udhëzime të tjera të brendshme. Auditimi për këtë çështje pati në konsideratë risqet që vijnë nga mungesa e politikave dhe procedurave të shkruara, si dhe nga praktikatat me të cilat institucioni zhvillon aktivitetin e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion Zyra Rajonale Statistikore Fier bazuar në rregulloren e brendshme të INSTAT miratuar me Vendimin nr. 7, datë 23.09.2024 të Bordit Drejtues, misioni i institucionit është ofrimi të prodhimit të statistikave të INSTAT për njësitë tematike dhe grumbullimi në kohë të dhënave cilësore. Zyra Rajonale Statistikore Fier kontribuon në pasurimin dhe përditësimin e databazave dhe regjistrave statistikore, nëpërmjet menaxhimit efektiv të aktiviteteve të vrojtimit në terren apo sigurimit të të dhënave nga burime administrative të disponueshme brenda juridiksionit të saj dhe përdorimit racional të fondeve në dispozicion.

Nga auditimi u konstatua se Teknologjia e Informacionit në Zyrën Rajonale Statistikore Fier zhvillohet në kushtet e mungesës së bazës rregullatore. Në Zyrën Rajonale Statistikore Fier në mungesë të stafit në fushën e teknologjisë së informacionit nuk janë marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave të proceseve të teknologjisë së informacionit në përputhje me aktet ligjore, nënligjore dhe praktikatat më të mira, duke mos konsideruar elementë të tillë si: rregulla mbi veprimtarinë e TI në institucion, rregulla mbi menaxhimin e incidenteve, procedura dhe indikatorë të matjes së performancës për gabimet/ incidentet e ndodhura dhe masat reaguese ndaj tyre. Mungesa e bazës së brendshme rregullatore për funksionimin e strukturave të teknologjisë së informacionit sjell operimin mbi baza ngjarjeje, duke rritur riskun e ekspozimit të institucionit ndaj situatave ku reagimi është i paidentifikuar, burimet njerëzore dhe përgjegjësitë të paalokuara, si dhe koha e përgjigjes e papërcaktuar.

Verifikimi i shkallës së sigurisë dhe aksesit në rrjet

Siguria e informacionit është e rëndësishme për institucionet, si pasojë e rritjes së kompleksitetit të kontrollit të aksesit dhe ruajtjes së konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë së të dhënave nga marrëdhëniet e rrjeteve publike me ato private dhe nga bashkë përdorimi i burimeve të informacionit. Siguria e Informacionit mund të përcaktohet si metoda e një sistemi për të mbrojtur informacionin dhe burimet e sistemeve në përputhje me kushtet e konfidencialitetit, integritetit dhe gatishmërisë. Lidhur nga sa më sipër, çdo institucion publik shtetëror që ofron shërbime ndaj qytetarëve e ka si detyrim ndërtimin e programit të sigurisë së informacionit me elementët kyç të cilët janë: “Mjedisi i sigurisë së informacionit, Vlerësimi i riskut, Politikat e sigurisë, Organizimi i sigurisë së TI, Menaxhimi i komunikimeve dhe operacioneve, Menaxhimi i asetëve, Siguria e burimeve njerëzore, Siguria fizike dhe mjedisore, Kontrolli i aksesit, Menaxhimi i incidenteve të sigurisë së TI”.

Verifikimi i shkallës së sigurisë me qëllim parandalimin e humbjes ose të dëmtimit të pajisjeve kompjuterike, aksesit të paautorizuar, kopjimit ose shikimit të informacionit sensitiv. Auditimi mbi shkallën e sigurisë kompjuterike u krye në bazë të manualit të auditimit IT, ISSAI 5310 dhe ISO 27001.

-Nga auditimi i Infrastrukturës Network dhe pajisjeve ndihmëse që nevojiten për shërbimet e komunikimit dhe ruajtjes së të dhënave ka rezultuar se është në kushtet minimale dhe jo optimale, ku shërbimet e ngritura mbi këto rrjete nuk janë të sigurta dhe nuk mbështesin vazhdimësinë e punës.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ekzistojnë politika të qarta për menaxhimin e aksesit të përdoruesve. Punonjësit ndajnë të njëjtat llogari të përdoruesve për hyrje në sistemet dhe aplikacionet e brendshme, gjë që e bën të pamundur gjurmimin e aktiviteteve individuale. Për më tepër, mungesa e një sistemi të bazuar në role mund të çojë në ekspozimin e të dhënave të

ndjeshme ndaj punonjësve që nuk kanë nevojë për to, duke krijuar rreziqe të brendshme gjatë procesit të punës.

-Nga auditimi u konstatua se nuk ka një firewall të instaluar dhe të konfiguruar, duke e lënë atë të ekspozuar ndaj kërcënimeve të jashtme si sulmet kibernetike, skanimet e portave dhe përpjekjet për hyrje të paautorizuar. Mungesa e një firewall-i gjithashtu e bën të vështirë monitorimin dhe filtrimin e trafikut të rrjetit për të parandaluar aktivitetet keqdashëse.

Për sa është trajtuar në këtë pikë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti i audituar janë paraqitur sqarime me shkresë nr.273/4 prot, datë 16.06.2025 “Mbi Projekt Raportin e auditimit.

Sqarimi i subjektit: Zyra Rajonale Statistikore Fier, pasi u njoh me Projekt Raportin cilëson të arsyeshme t’i paraqesë Kontrollit të Lartë të Shtetit, komente dhe shpjegime në lidhje me gjetjet e auditimit referuar shkresës së sipër cituar.

-Referuar gjetjes mbi mungesën e një pozicioni të dedikuar të teknologjisë së informacionit në strukturën e Zyrës Rajonale të Statistikave Fier, sqarojmë se, në përputhje me strukturën organizative të Brendshme të INSTAT, Zyra Rajonale Fier është njësi varësie që nuk përfshin pozicione të dedikuara për specialistë të TI. Të gjitha funksionet lidhur me menaxhimin, mirëmbajtjen dhe sigurinë e infrastrukturës teknologjike realizohen në mënyrë të centralizuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) në INSTAT qendër. Është DTI-a që siguron mbështetje teknike për zyrat rajonale – përfshirë ZRS Fier - përmes ndërhyrjeve të planifikuara ose sipas nevojës. Kjo drejtori kryen monitorim dhe inspektime periodike për të garantuar funksionimin e pajisjeve fundore dhe të të gjitha çështjeve që kanë të bëjnë me infrastrukturën TI.

-Referuar gjetjes mbi mungesën e një infrastrukturë rrjeti të centralizuar dhe të një firewall-i të instaluar në Zyrën Rajonale të Statistikave Fier, sqarojmë se aktualisht ZRS Fier nuk disponon një rrjet të brendshëm apo serverë lokalë që të kërkojnë menaxhim të dedikuar rrjeti. Funksionet e ZRS Fier kufizohen në procesin e administrimit të mbledhjes së të dhënave në terren. Komunikimi me INSTAT qendër realizohet nëpërmjet email-it zyrtar, i cili menaxhohet në mënyrë qendrore nga DTI në INSTAT qendër. Në çdo rast, nëpërmjet email-it zyrtar nuk lind nevoja për transmetim të dhënash dhe ai përdoret kryesisht për qëllime administrative dhe në funksion të realizimit të detyrave funksionale të ZRS-së Fier. Aktualisht, masat e sigurisë së informacionit për ZRS Fier sigurohen në mënyrë të centralizuar nga Drejtoria e Teknologjisë së Informacionit (DTI) në INSTAT qendër, përmes:

- përdorimit të platformës së mbrojtjes me antivirus të menaxhuar në distancë,
- politikave të forta të fjalëkalimeve dhe aksesit të email, të zbatuara në mënyrë të detyrueshme përmes sistemeve qendrore,
- dhe mbështetjes teknike në distancë apo ndërhyrjet në vend në rast nevojë.

Kjo situatë është adresuar në mënyrë proaktive nga INSTAT duke planifikuar investimet për ngritjen e një infrastrukture intranet të centralizuar që do të lidhë zyrat rajonale me qendrën, në kuadër të Planifikimit Buxhetor Afatmesëm (PBA 2026–2028).

-Referuar konstatimit mbi mungesën e një rregulloreje për backup dhe të praktikave të realizimit të kopjeve rezervë në Zyrën Rajonale të Statistikave Fier, sqarojmë se kjo njësi nuk menaxhon apo ruan të dhëna në mënyrë të pavarur, dhe për rrjedhojë nuk ka procese të lokalizuara për backup të të dhënave. Proceset e ruajtjes, përpunimit dhe mbrojtjes së të dhënave janë tërësisht të qendëruara dhe menaxhohen nga INSTAT qendër. Në këtë kuadër, realizimi i kopjeve rezervë dhe rikuperimi i të dhënave në rast incidentesh ndjek politikat institucionale.

-Në përputhje me rekomandimin e dhënë, DTI pranë INSTAT do të fillojë një proces të ri konfigurimi të profilit të përdoruesve, për të forcuar ndarjen e roleve dhe për të kufizuar privilegjet e administratorëve lokale vetëm në raste të domosdoshme dhe të dokumentuara, si dhe për të aplikuar kontroll të shtuar. Ky proces do të shoqërohet me monitorim të rregullt, për të parandaluar keqpërdorimet, minimizuar gabimet njerëzore dhe rritur sigurinë institucionale.

-Referuar konstatimit mbi mungesën e një rregulloreje të posaçme për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në nivelin lokal të Zyrës Rajonale të Statistikave Fier, sqarohet se menaxhimi i teknologjisë së informacionit në të gjitha zyrat rajonale të INSTAT realizohet në mënyrë të qendëruar pranë INSTAT qendër. Politikat dhe rregulloret ekzistuese të institucionit, janë të detyrueshme për të gjitha njësitë e INSTAT, përfshirë zyrat rajonale. Në përputhje edhe me rekomandimin 5.1, INSTAT-i do të marrë në konsideratë hartimin e një udhëzuesi praktik të dedikuar për zyrat rajonale, i cili do të shërbejë si shtesë operationale ndaj politikave qendrore.

- INSTAT ka ofruar dhe vazhdon të ofrojë trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme për stafin e zyrave rajonale, përfshirë edhe elementë të përpunimit të të dhënave statistikore, mbrojtjes së informacionit dhe përdorimit të aplikacioneve të ndryshme. Këto trajnime realizohen nga INSTAT qendër dhe kanë për qëllim përditësimin e njohurive dhe ndërtimin e kapaciteteve për përmbushjen sa më mirë të detyrave funksionale. Në vijim të këtij angazhimi, gjatë vitit 2025, për Zyrat rajonale janë planifikuar trajnimet mbi Sigurinë Kibernetike; përpunime të dhënash statistikore në Excel dhe programe më specifike statistikore si SPSS, përdorimi i email zyrtar në mënyrë të sigurt dhe efektiv, simulime për sulme të ndryshme kibernetike, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: *Grupi i Auditimit ka konstatuar se mungojnë evidenca të mjaftueshme në nivel lokal që vërtetojnë gjetjet e konstatuara. Mungesa e politikave të dokumentuara, menaxhimin e aksesit, si dhe mungesa e pajisjeve mbrojtëse, përbëjnë dobësi që cenojnë sigurinë dhe vazhdimësinë e shërbimeve edhe nëse administrimi kryhet nga qendra.*

2.2 Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave Statistikore

Zyra Rajonale Statistikore (ZRS) Fier merr nga Sektori i Koordinimit të Mbledhjes së të Dhënave, INSTAT qendër “Kalendarin e vrojttimeve” në të cilin janë të përcaktuara (miratuara) të gjitha anketat e planifikuara që do të kryhen brenda vitit kalendarik si dhe planifikimi mbi, numrin dhe llojin e njësive statistikore që do të vrojtohen, metodën e mbledhjes së të dhënave në terren, numrin e anketuesve të planifikuar si dhe planifikimin për datat e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes së të dhënave në çdo vrojtim. Manuali i procedurave të ZRS-ve ndihmon për çdo hap që ndiqet gjatë gjithë vitit kalendarik. Kalendarin si dhe Manualin i procedurave shërben për planifikimin dhe organizimin e punës si ZRS- Fier. Procesi i mbledhjes së të dhënave në terren fillon me marrjen shpresore të urdhrat të miratuar nga titullari i institucionit, urdhër i cili i dërgohet nëpërmjet postës elektronike. Në urdhër përcaktohet titulli i vrojtimit, numri dhe tipi i njësive statistikore që do të vrojtohen, metoda e mbledhjes së të dhënave në terren, numri i anketuesve si dhe datat e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes së të dhënave për ZRS Fier. ZRS Fier, shpërndan punën për numrin e anketuesve në terren (pyetësorët letër për vrojtimit me pyetësorë fizik apo pajisjen elektronike për vrojtimit të cilat realizohen me pajisje elektronike). Anketuesit realizojnë intervistat pranë njësive statistikore të përcaktuara.

Gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave punonjësit e ZRS Fier:

- Menaxhojnë procesin e mbledhjes së të dhënave dhe aktivimin e anketuesve;
- Monitorojnë/kontrolojnë zbatimin e saktë të metodologjisë së anketës;
- Ushtrojnë kontrole rastësore mbi cilësinë e marrjes së të dhënave;
- Raportojnë ecurinë e punës në mënyrë periodike në INSTAT;
- Monitorojnë zbatimin e afateve kohore të anketës.

Anketuesit mbajnë kontakte me specialistin e ZRS Fier, i cili ndjek anketën duke dhënë informacion mbi progresin e të dhënave në terren.

Në përfundim të mbledhjes së të dhënave në terren për vrojtimit me pyetësorë letër të dhënat e grumbulluara, të papërpunuara, dërgohen në INSTAT nëpërmjet shërbimit postar.

Për vrojtimit ku mbledhja e të dhënave kryhet nëpërmjet pajisjeve elektronike, të dhënat e grumbulluara transmetohen në serverët qendrorë të INSTAT-it, përmes aplikacioneve përkatëse të zhvilluara për secilën anketë.

ZRS Fier është përgjegjëse dhe realizon vetëm procesin e mbledhjes së të dhënave të papërpunuara në terren. ZRS Fier nuk realizon asnjë proces të përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave statistikore. Përpunimi realizohet në INSTAT qendër (Tiranë).

- Nga Auditimi u konstatua se Zyra Rajonale Statistikore Fier është përgjegjëse vetëm për mbledhjen e të dhënave në terren dhe nuk realizon asnjë përpunim apo ruajtje të të dhënave statistikore. Të dhënat fizike dërgohen në INSTAT përmes shërbimit postar, ndërsa ato elektronike transmetohen në serverët qendrorë përmes aplikacioneve të dedikuara.

IV. REKOMANDIME

A.MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Në strukturën organizative të Zyrës Rajonale Statistikore Fier konstatohet se, nuk ka specialistë që mbulon fushën e teknologjisë së informacionit, për të garantuar sigurinë e informacionit referuar standardit ISO/IEC 27001 dhe praktikave më të mira kombëtare e ndërkombëtare. Mungesa e këtij specialisti nuk adreson në kohë problemet teknike, si dhe nuk zbatohen në mënyrë të vazhdueshme politikat dhe masat e sigurisë kibernetike të teknologjisë së informacionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistikore Fier të kërkojë nga Instituti i Statistikave (INSTAT), asistencë dhe konsulencë për të adresuar rreziqet dhe masat që duhet të marrë për rritjen e sigurisë kibernetike të teknologjisë së informacionit.

Menjëherë dhe në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer në Zyrën Rajonale Statistikore Fier u konstatua se infrastruktura për menaxhim dhe monitorim të pajisjeve kompjuterike dhe të drejtave të përdoruesve nuk është e qendërzuar lokalisht apo në nivel qendror. Ky konfigurim e ekspozon ZRS Fier ndaj rreziqeve të sigurisë së informacionit me pasoja në humbjen e të dhënave që ruajnë në pajisjet kompjuterike, në mospërputhje me ISO/IEC 27001 dhe praktikën e administrimit të TI.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistikore Fier në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), të marrë masa për krijimin e një rrjeti të qendërzuar për minimizimin e rreziqeve në drejtim të sigurisë si dhe një menaxhim më të kontrolluar të infrastrukturës.

Brenda vitit 2025

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se për Zyrën Rajonale Statistikore Fier nuk janë përcaktuar dhe adresuar detyra dhe përgjegjësi për ruajtjen e të dhënave elektronike që krijohen dhe ruhen lokalisht tek çdo përdorues nga aktiviteti operacional i punonjësve. Mungesa e kësaj praktike e ekspozon institucionin ndaj humbjes së tyre dhe nuk është në përputhje me praktikën më të mira të sigurisë ISO/IEC 27001:2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistikore Fier në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), të marrin masa për ruajtjen e të dhënave elektronike që krijohen dhe ruhen lokalisht tek çdo përdorues, për të garantuar rikuperimin e shpejtë të informacionit në rast incidenti.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se të gjithë përdoruesit i aksesojnë kompjuterët si administrator lokal, pra me të drejta të plota për të kryer lirisht veprime, mes tyre dhe instalime të ndryshme *software* pa nevojën e një aprovimi paraprak, çfarë cenon sigurinë e të dhënave në këto pajisje dhe në rrjetin e brendshëm, sikurse përcaktohet në Standardin

Ndërkombëtar të Sigurisë së Informacionit ISO/IEC 27001:2022 dhe udhëzimeve në zbatim të tij.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistike Fier të marrë masa për kufizimin e të drejtave të përdoruesve, duke hequr aksesin e panevojshëm si administrator lokal si dhe duke implementuar parimin e privilegjit minimal.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se Zyra Rajonale Statistike Fier nuk disponon rregullat bazë udhëzues për menaxhimin e teknologjisë së informacionit në kushtet e funksionimit të saj, sipas kërkesave të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, çfarë rrit rrezikun për veprime të pa unifikuara, pa përgjegjësi individuale dhe me ekspozim të lartë ndaj gabimeve apo incidenteve të sigurisë. Politikat dhe rregulloret e INSTAT janë të orientuara në nivel qendror dhe nuk përfshijnë udhëzime të detajuara që duhen ndjekur në zyrat rajonale.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqet 9-11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistike Fier në bashkëpunim me Institutin e Statistikave (INSTAT), të hartojë dhe të miratojë rregullat bazë udhëzues për menaxhimin e teknologjisë së informacionit për nivelin lokal.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Zyra Rajonale Statistike Fier ka përgjegjësi vetëm për mbledhjen e të dhënave në terren, por nuk janë përdorues të sistemeve qendrore të INSTAT për plotësimin e të dhënave statistikore. Komunikimi për të dhënat e nevojshme që kërkohen nga INSTAT, realizohet nëpërmjet rrugëve alternative që janë posta elektronike ose shërbimi postar, në kundërshtim me Ligjin Nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare, neni 12.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqja 11 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1 Rekomandimi: Zyra Rajonale Statistike Fier në bashkëpunim me INSTAT, të marrin masa për dhënien e aksesit në sistemet qendrore në të cilën regjistrohen dhe përpunohen të dhëna statistikore.

Menjëherë

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT